



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 379/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj, dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) - Prishtinë, për shkak të mospërputhjes së fletëvotimeve më kuvertat, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të datës 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 21.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Aleanca Kosova e Re (AKR), dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 19.06.2014, nga subjekti politik AKR dega në Prishtinë, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit të votave nuk përputheshin kuvertat (zarfët) me fletëvotimet, prandaj numërimi ishte bërë katër herë dhe gjithnjë nuk përputheshin rezultatet. Parashtruesi i ankesës thekson se pas shumë debatesh njëri nga numëruesit i sollti edhe tre zarfa, por që nuk ishin nga kutia që numërohej dhe prapë kjo kuti është mbyllur pa përputhje të rezultateve.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmitarit ka propozuar Ismet Mulaj.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP ka konstatuar se pretendimet ankimore të subjekti politik AKR janë të pabazuara pasi që parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë për ti argumentuar pretendimet e parashtruara në ankesë.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bërë asnjë përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën dhe kohën e shkeljes së supozuar, për mëtej parashtruesi nuk ka dhënë asnjë dëshmi, kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rast kur të njëjtat nuk gjenden në posedim të ankuesit siç kërkohet sipas nenit 3.6 pikat (b) dhe (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 379/2014 më datën 21.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*